

# STATUT

## I SHOQËRISË TREGETARE " TIME Gourmet " SH.P.K.

Në këtë statut

- "Ligi" është Ligi Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

### NENI 1

#### DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT

(1) Sot, më 31.10.2024, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **TIME Gourmet .shpk.**

(2) Themeluesit e shoqërisë janë :

Themeluesit e shoqërisë janë:

1 - Enzo Alia, i biri i Tonin-it, lindur me date 19/01/2000, ne Tirane dhe banues ne Rruga "Rr Perlat Rexhepi, Tirana, shtetas shqiptar me zotësi t plotë juridike pir të vepruar, i identifikuar me dokumentin tip Icternjostim ID nr. 0330025760 dhc Numer Personal K00119036Q;

2 - James Doshi, i biri i Tomc-s, lindur me date 20.02.2000, ne Australi dhe banues ne Rruga "Nokolla Zoragi", Nd. 11, 1.1, Tirana, shtetas shqiptar me zotësi te pote juridike per te vepruar, i identifikuar me dokumentin tip Ilcternjostim ID Nr. 034218785 dhc Numër Personal K00220048B

3- Even Babasi, i biri i Ndriçimit-it, lindur me datë 06/06/1999, në Tiranë dhe banues në Rruga "Rr. Free Ukraine, Tirana, shtetas shqiptar me zotësi të plotë juridike për te vepruar, i identifikuar me dokumentin tip Pasaporte nr. BR2245344 dhic Numr Personal J90606062J);

4- Altin Kore, i biri i Arben-it, lindur me datë 17/06/1976, në Gjirokaster dhe banues në Rruga "Dobresh, Berzhite shtetas shqiptar me zotësi të plotë juridike për te vepruar, i identifikuar me dokumentin tip leternjoftim me Numr Personal H60617138J)

### NENI 2

#### OBJEKTI

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

Shoqëria Mund të kryej në Republikën e Shqipërisë çdo aktivitet që nuk ndalohet nga ligjet në fuqi.

- Restaurant
- Bar-Kafe
- Prodhim dhe distribucion I artikujve te ndryshem ushqimore
- Sherbim Catering / Delivery
- Tregëtimin e artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve me pakicë si:
- Tregëtim artikuj të ndryshëm industrial;
- Tregëtim artikuj të ndryshëm ushqimore;
- Tregëtim artikuj të ndryshëm bujqësore e blegtore;
- Tregëtim piye alkolike të ndryshme;
- Tregëtim mallrash të të gjitha llojeve Brenda dhe jashtë vendit;
- Hapje dhe shfrytëzim hotelesh, motelesh, diskotekash, bar-kafë, lojra argëtuese për fëmijë, qendër sportive, qendra pushimi e kërrative;
- 5. Objekti i shoqërise mund të plotësohet e modifikohet në çdo kohë me miratimin e Asamblesë së Ortakeve/Ortakut në përputhje me ligjet përkatëse.
- 6. Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera që kanë objekt të ngjashëm me të, etj.

**NENI 3  
KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë caktohet pa afat.

**NENI 4**

**SELIA**

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rr. Brigada 8, Rr. Moti 14.

**NENI 5**

**KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100'000 ( njëqindmijë ) Lekë (\*sipas ligjit kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100 lekë\*).

Kapitali themeltar fillestar i shoqdrist #shtt 100000 ( njeqindmiie ) Leke 1 perbere nga tre (4) kuota

Pjesëmarja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Pjesëmarja e themeluesve në kapitalin c shoqerisë eshte ne perputhje me kontributet e tyre te mëposhtme:

I. Ortaku themelues :

Eno Alia: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere të pergiithshme 25 000 ( njezet e pese mijë ) leke qe përbën 25% te kapitalit themeltar të shoqërisë.

2. Ortaku: James Doshi, Zoterues i 1 (njc) kuote me vlerë të përgjithshme 25 000 (njezet e pese mijë )

Ickë që përbën 25% të kapitalit themeltar të shoqrisi.

3. Ortaku: Even Babasi, Zotcrues i I (nje) kuote me vicerë t8 përgjithshme 25 000 (njezet e pese mijë )

lekç që përbën 25% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

4. Ortaku: Altin Kore, Zotcrues i I (nje) kuote me vicerë t8 përgjithshme 25 000 (njezet e pese mijë )

lekç që përbën 25% të kapitalit themeltar të shoqërisë

Kontributi I ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri tç luajtshme/te pa luajtshme apo të drejta)

**NENI 6**

**ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.  
Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### **NENI 7 TRANSFERIMI I KAPITALIT**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kuqizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligji.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

### **NENI 8 ORGANI VENDIMMARRËS**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligji.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadrjinin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

### **NENI 9**

### **MËNYRA E THIRRJES SE MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë

vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar përmblidhet e asamblesë. 4

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, përmblidhet e asamblesë.

#### NENI 10 KUORUMI

Në rastin e martjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 përmblidhet e asamblesë.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë përmblidhet e asamblesë përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet përmblidhet e asamblesë së kuorumi të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### NENI 11 MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, përmblidhet e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;

- a) përcaktimi i politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- c) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

#### NENI 12 PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim përmblidhet e asamblesë;

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- c) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### NENI 13 ADMINISTRIMI

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emëritimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit: dhe specimenët e nënshkrimit:

**Altin Kore**, I biri I Arben-it, lindur me datë 17/06/1976, në Gjirokaster dhe banues në Rrugë Dobresh Berndhi shtetas shqiptar me zotesi të plotë juridike për te vepruar, I identifikuar me dokumentin tip leternjoftim me Numer Personal H60617138J):

**Altin KORE**

Adresë :

(emri, mbiemer, nënshkrim )

**NENI 14**  
**KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen përmajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruanjë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, tregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### NENI 15 PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose 6 solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid; b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij më profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpérndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financier, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

### NENI 16 VITI FINANCIAR

Viti finanziar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përashtimisht, viti i parë 31 Dhjetor.

#### NENI 17 EKSPERTËT

Eksperti ka per detyre që të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithvejetore dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorezoje në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

#### NENI 18 PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asambleze se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtar tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

Në këtë rast Ortaket merrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në cdo dokument të nxjerë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesë shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Prishja e shoqëritë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjëndjen e aftësisë paguese, me përashtim të rasteve kur ështënisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### NENI 19 RIORGANIZMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA


Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

#### NENI 20 BAZA LIGJORE

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e tij në perputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit Shqiptarë.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### NENI 21



### MOSMARRËVESILJET


Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

*ORTAKET*

*E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR*

TIME .shpk

JAMES DOSHI



EVEN BABASI



ENO ALIA



ALTIN KORE

